

VENDIM
Nr. 106, datë 24.2.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM
LETRASH, TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, PËR SHITESËN E DYTË TË FINANCIMIT PËR PROJEKTIN E
SIGURISË SË DIGAVE, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 61/2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të Marrëveshjes së Huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, ratifikuar me ligjin nr. 61/2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

BANKA BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE

IBRD-IDA/GRUPI I BANKËS BOTËRORE

Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

LINDA VAN GELDER
Drejtores Rajonale, Ballkani Perëndimor
Evropa dhe Rajoni i Azisë Qendrore

21 dhjetor 2020

Znj. Anila Denaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

E nderuar znj. Ministre,

Shqipëri: Programi i Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore APL5 – Projekti i Sigurisë së Digave

Huaja e IBRD-së nr. 8862
Shtyrja e datës së mbylljes

Ne i referohemi Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”), të datës 21 qershor 2018, për Programin e Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore APL5 – Projekti i Sigurisë së Digave (“Projekti”), dhe Projektmarrëveshjes ndërmjet Bankës Botërore dhe KESH-it (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare) të së njëjtës datë si projekti. Ne gjithashtu i referohemi letrës suaj të

datës 30 tetor 2020, me anë të së cilës i kërkon Bankës Botërore që të shtyjë datën e mbylljes së huas me titull të mësipërm, të parashikuar në Marrëveshjen e Huas.

Ne kemi kënaqësinë t'iu informojmë se Banka Botërore ka caktuar datën 31 dhjetor 2021 si datën e mëvonshme për qëllimet e seksionit IV.B2, të kapitullit 2, të Marrëveshjes së Huas.

Me respekt,

LINDA VAN GELDER
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Evropa dhe Rajoni i Azisë Qendrore

Për dijeni: Znj. Belinda Balluku, Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë;
Znj. Adela Xhemali, Zv. Ministre e Financave dhe Ekonomisë;
Z. Ilir Bejtja, Zv.Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë;
Z. Benet Beci, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, KESH;
Z. Skerdi Drenova, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, OST;
Z. Adrian Cela, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, OSHEE;
Z. Fatos Bundo, Drejtor i PMU-KESH;
Znj. Majlinda Dhuka, Zv. Sekretar i Përgjithshëm dhe Drejtor i Përgjithshëm i
Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, Këshilli i Ministrave;
Z. Matteo Bugamelli, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore;

Tel: +43 (1) 2170 782

Faks: + 43 (1) 2170 701